



DEMOS



KRATOS

## FUQIA E POPULLIT


TRIM (11), BLEARTA (11), MUHAMED (11), ALTUNA (11), ENDI (11), ELSA (12)



### Nga ne do të mësoni se si populli ka fuqi në një shtet demokratik

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë fuqi ose pushtet. Demokracia për herë të parë u shfaq në Athinë në vitin 507 para erës sonë. Në atë kohë, të drejtë vote kishin vetëm burrat dhe të pasurit, që do të thotë se nuk ka pasur demokraci të plotë. Kurse tash kemi demokraci më të plotë, sepse të gjithë kemi të drejtë vote nga mosha 18 vjeçare. Po ashtu, në këtë kohë kemi të drejta të barabarta, kemi liri, respekt, shprehje të lirë të mendimit pa marrë parasysh gjininë, racën, fenë etj. Këto që u përmendën më lart, janë vetëm disa prej elementeve të demokracisë që aplikohen sot dhe për të cilat ka nevojë të punohet edhe me shumë, në mënyrë që të gjithë të jetojmë të lumtur. Prandaj, meqenëse demokracia përmban elemente shumë të rëndësishme për jetën e çdo qytetari, secili vend dëshiron të

jetoj me parimet kyçe të demokracisë. Demokracia ndahet në demokraci të drejtpërdrejtë dhe demokraci përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: demokracia përfaqësuese parlamentare dhe demokracia përfaqësuese presidenciale. Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare, ku populli zgjedh deputetët të cilët përfaqësojnë popullin, miratojnë ligjet dhe zgjedhin Qeverinë. Populli i Kosovës ka 120 deputetë ose përfaqësues të cilët punojnë për të mirën e vendit. Prandaj, lexues të dashur nga ne populli kërkohet që t'i zbatojmë sa më shumë parimet e demokracisë si: lirinë, paqen, solidaritetin, respektin në mënyrë që shteti ynë të funksionoj sa më mirë. Po ashtu, nga ne kërkohet që të jemi pjesë aktive e procesit zgjedhor nga mosha 18 vjeçare, sepse ne jemi ata që kemi më së shumti fuqi dhe vetëm kështu mund ta ndërtojmë edhe më shumë demokracinë e vendit tonë.



Ti duhesh të jesh qytetar aktiv në vendin tënd



Ne kontribuojmë për demokracinë e vendit tonë

# KUJDESI YNË PËR VENDIN TONË

EDUART (11), ENIS (11), ALTION (12), ALBENA (11), ALTINA (11) NATYRA (11)

## Përgjegjësia jonë si qytetarë aktiv

Në demokraci çdo njeri ka të drejtën e jetesës, të lirisë dhe të sigurisë personale. Njerëzit kanë arsye dhe ndërgjegje, prandaj duhet të sillen mirë me njëri-tjetrin dhe të kenë frymë vëllazërie. Të jesh qytetar aktiv do të thotë të jesh aktiv në punë, në shkollë, në shtëpi etj. Ne si qytetarë duhet të jemi human, të mbrojmë vendin tonë dhe të veprojmë për një të ardhme të mirë. Si shembull, mund të merret sesi një organizatë jo qeveritare, mund të marrë iniciativë të vetëdijësoj qytetarët për dëmin që e shkakton ndotja e ambientit. Të gjithë qytetarët i kanë të drejtat e barabarta, pa dallim feje, gjinie, race, kombësie etj. Grupi ynë ka një mesazh për ju, të jemi shpirtmirë dhe ta duam njëri-tjetrin.



Ne jemi e ardhmja



Ne punojmë së bashku



Ne jemi të lumtur dhe kemi respekt ndaj njëri-tjetrit



Reciklimi i mbeturinave



E drejta e punës

# NDARJA E PUSHTETIT NË DEMOKRACI

DENAT (11), ANID (11), ELONA (11), ENIT (11), ERINA (11), ERZA (11)



## Demokracia është mënyrë e qeverisjes së një vendi ku pushteti ndahet në tri pjesë. Lexojeni artikullin tonë për t'u informuar më shumë

Ne sot kur kemi ardhur në Punëtoritë e Demokracisë „Demos-ti“ jemi ndarë në tri grupe. Secili grup ka diskutuar dhe punuar rreth një teme të caktuar. Kështu, të gjithë artikujt janë bashkuar dhe është krijuar kjo gazetë. Ne i kemi ndarë punët në mënyrë që ta arrijmë qëllimin tonë më lehtë, e që është shkrimi i gazetës. Nëse veç një grup do ta merrte përsipër shkrimin e gazetës, atëherë ai grup do të ngarkohej shumë. Për këtë arsye ne i kemi ndarë punët.

Njësoj ndodh edhe në demokraci. Në mënyrë që një institucion të mos ngarkohet më shumë se tjetri, pushteti në demokraci ndahet në: Pushtetin Legjislativ, Pushtetin Ekzekutiv dhe Pushtetin Gjyqësor.

Që të tri këto pushtete kanë nga një institucion përfaqësues. Pushteti Legjislativ përfaqësohet nga Kuvendi. Pushteti Ekzekutiv përfaqësohet nga Qeveria. Ndërkaq, Pushteti Gjyqësor përfaqësohet nga gjykatat. Kuvendi ka tri funksione kryesore: funksionin legjislativ, ku i miraton ose nuk i miraton ligjet. Funksionin përfaqësues, sepse na përfaqëson neve (popullin). Si dhe funksioni kontrollues sepse kontrollon Qeverinë. Ne i zgjedhim 120 deputetë të cilët punojnë në Kuvend. 100 deputetë janë qytetarë të komunitetit shumicë, pra i përkasin kombit shqiptar. Ndërkaq, 20 deputetë të tjerë iu takojnë komuniteteve jo shumicë, siç

janë: romët, turqit, serbët, egjiptasit, ashkalinjtë dhe boshnjakët.

Mbledhjet të cilat mbahen nga deputetët quhen seanca plenare. Këto mbledhje parashihet të mbahen çdo të enjte.

Qeveria ka për detyrë zbatimin e ligjit, mirëqënien e popullit, përgatitjen si dhe dërgimin e projektligjeve në Kuvend.


Ndërkaq, gjykatat dënojnë ose jo qytetarët të cilët dyshohet se e kanë shkelur ligjin. Në Kosovë, gjykatat ndahen në tri gjykata: Gjykata Themelore, Gjykata Supreme si dhe Gjykata e Apelit. Ne mendojmë se është shumë mirë që pushteti ndahet sepse kështu detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve janë më të sistemuara. Lexues të dashur, mos harroni se jetët tona ndikohen shumë nga vendimet që marrin këto institucione. Prandaj, duhet të zgjedhim me kujdes deputetët tonë si dhe duhet të jemi qytetarë të ndershëm dhe të respektojmë ligjin.



Autorët e artikullit



Demokracia, udhëheqje e popullit



Elementet e demokracisë




Ne ndihmojmë njëri-tjetrin



Bashkëpunimi ynë në grup



Funksionet kryesore të Kuvendit



Ndarja e Pushtetit



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-3  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë